



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**U R D H Ë R**  
**Nr. 141 Datë 20. 04. 2004**

**PËR**  
**IDENTIFIKIMIN E AVOKATIT**

***Me synim,***

- për të identifikuar avokatët që marrin pjesë në kryerjen e veprimet hetimore paraprake, në gjykim ose në ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe;
- për të shmangur çdo mundësi abuzive dhe në kundërshtim me ligjin në përfaqesimin me avokat të interesave të subjekteve të procedimit penal që kjo e drejte u garantohet me ligj;

***Mbështetur,*** në nenin 24 pika 4 e vijues të K. Pr. Penale, nenin 8 pika 2 të ligjit Nr. S737 date 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë " dhe në vendimin përkatës të Dhomës Kombëtare të Avokatëve të Shqipërisë;

**U R D H Ë R O J :**

1. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, në Prokurorite e të gjithë niveleve, nuk duhet të lejojnë asnjë avokat për të marrë pjesë në kryerjen e veprimeve hetimore paraprake, në shqyrtimin gjyqësor dhe në ekzekutimin e vendimeve penale, pa qenë i paisur me karteu e identitetit të vitit kalendarik.
2. Në aktet procedurale penale që kryhen me pjesëmarrjen e avokatit krahas emrit të avokatit, duhet të shënohet edhe numri i kartës së identitetit të tij.
3. Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve, si dhe drejtuesit e Prokurorive të të gjitha niveleve dht të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

- 4-. Mospërbushja e detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, përbën shkelje të disiplinës në punë.
5. Me këtë urdher të njihen prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve, si dhe drejtuesit e Prokurive të të gjithë niveleve.
6. Urdhëri i Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 19 datë 8. 02. 2001 dhe çdo akt tjetër normativ që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.
7. Ky urdher hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**THEODHORI SOLLAKU**